



# NJOFTIM PËR SHTYP

## Datë 29.03.2024

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ka kryer hetime kryesisht në kuadër të procedimit penal Nr. 214, të vitit 2023, për veprat penale “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera”, “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, kryer në bashkëpunim, “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale”, kryer në bashkëpunim, parashikuara nga nenet 258, 244-25, 259, 287/2 të Kodit Penal.

Në vijim të njoftimeve të mëparshme, për faktin penal të rezultuar dhe personat e dyshuar (**njoftim i datës 14.03.2024**), Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr.164, datë 18.03.2024, ka vendosur:

1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;
2. Vendosjen e masës së sigurimit pasuror “sekuestro preventive” mbi pasuritë e mëposhtme:
  - Kuotat e shoqërisë “DAAM” sh.p.k., me ortak personin nën hetim V. B. dhe administrator personin nën hetim E. L.;
  - Pasurinë e paluajtshme Nr.80/2, e llojit “arë”, me sipërfaqe 25,100 m<sup>2</sup>, me adresë Mangull, Tiranë, vetëm mbi pjesën takuese të shoqërisë “DAAM” sh.p.k.
  - Pasurinë e paluajtshme e llojit “arë” me sipërfaqe 1,000 m<sup>2</sup>, me adresë Mangull, Tiranë, vetëm mbi pjesën takuese të shoqërisë “DAAM” sh.p.k.;
  - Pasurinë e paluajtshme e llojit “arë”, me sipërfaqe 1,080 m<sup>2</sup>, me adresë Mangull, Tiranë, vetëm mbi pjesën takuese të shoqërisë “DAAM” sh.p.k.;
  - Pasurinë e paluajtshme e llojit “arë”, me sipërfaqe 2,055 m<sup>2</sup>, me adresë Mangull, Tiranë, vetëm mbi pjesën takuese të shoqërisë “DAAM” sh.p.k.;
  - Pasurinë e paluajtshme me sipërfaqe 5,000 m<sup>2</sup>, me adresë Mangull, Tiranë, vetëm mbi pjesën takuese të shoqërisë “DAAM” sh.p.k.;
  - Automjetin e markës “SKODA”, modeli “FABIA”, viti i prodhimit 2019;

- Automjetin e markës “JEEP”, modeli “COMPASS”, viti i prodhimit 2011;
- Automjetin e markës “BMW”, modeli “X3”, viti i prodhimit 2004;
- Automjetin e markës “FORD”, modeli “KUGA”, viti i prodhimit 2011;
- Motomjetin e markës “DAYANG”, modeli “DY125T-32”, viti i prodhimit 2022;
- Automjetin e markës “KIA”, modeli “SELTOS”, viti i prodhimit 2020;
- Automjetin e markës “HYUNDAI”, modeli “AVANTE”, viti i prodhimit 2020;

*Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm derisa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë.*

# Njoftimet e Fundit

---